



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të programit trevjeçar dhe dyvjeçar të formimit fillestar dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

- 1.1 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.2 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.3 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.4 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.5 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.6 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.7 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.8 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.9 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.10 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.11 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.12 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.13 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.14 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.15 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.16 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.17 Për caktimin në pozicion të znj. {...};

- 1.18 Për caktimin në pozicion të z. {...};
1.19 Për caktimin në pozicion të znj. {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 14:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.***

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të programit trevjeçar dhe dyvjeçar të formimit fillestar dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

- 1.1 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.2 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.3 Për caktimin në pozicion të znj. {...}
- 1.4 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.5 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.6 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.7 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.8 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.9 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.10 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.11 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.12 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.13 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.14 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.15 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.16 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.17 Për caktimin në pozicion të znj. {...};
- 1.18 Për caktimin në pozicion të z. {...};
- 1.19 Për caktimin në pozicion të znj. {...}.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Duke qenë se të gjithë gjyqtarët anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 27 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, në rend dite janë 5 çështje, për të cilat kërkohet vendimarrja e KLGJ-së.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve mbi caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të programit trevjeçar dhe dyvjeçar të formimit fillestar dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për zëvendësimin e Nëpunësit Përgjegjës për vlerësimin z. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve lidhur me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}; komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} dhe caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura po nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, lidhur me përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...}, si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë; komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} dhe caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Çështja e fundit ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë (shtyrë nga mbledhja e datës 20.10.2020).

Nëse jemi dakord, kalojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, ku fjalën ia jap zotit zotit Toska.

Illir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur 19 projektvendime “Për caktimin në pozicion të gjyqtarëve të emëruar në datën 20.10.2020”. Krahas projektvendimeve ju është shpërndarë dhe relacioni shpjegues në lidhje me këto. Shkurtimisht mund t’ju them se, sikurse jeni në dijeni, emërimi i magjistratëve të rinj dhe caktimi në pozicion i tyre ka qenë prioritet i punës së Këshillit Lartë Gjyqësor kjo, jo vetëm për shkak të detyrimit ligjor, por dhe për shkak të nevojave që kanë gjykatat për gjyqtarë. Emërimi i tyre dhe caktimi në pozicion ka një procedurë të mirëpërcaktuar në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli, pasi përfundoi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtarë të kandidatëve të cilën kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020, për të dy kategoritë e magjistratëve, pra për ata të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar dhe për ata të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit, bazuar në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020 bëri emërimin e tyre si gjyqtar, mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu Këshilli, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020, pozicionet e lira në sistemin gjyqësor, si dhe faktin që gjyqtarët e emëruar vinin nga dy kategori kandidatësh, me Vendimin nr. 484, datë 20.10.2020, shpalli 13 pozicione të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020, ndërsa me Vendimin nr. 485, datë 20.10.2020, shpalli 6 pozicione të lira për të diplomuarit në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht neni 39, pika 3, e Ligjit 96/2016, pasi thekson që gjyqtarët e diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, pas emërimit të tyre si gjyqtar, kanë përparësi në caktimin e tyre në pozicion, parashikon që ky caktim bëhet duke respektuar kriteret si vijon:

a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, të bërë nga Shkolla e Magjistraturës, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale;

b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, për tri gjykata.

Pra, kriteri kryesor për caktimin në pozicion të të emëruarve është renditja e bërë nga Shkolla e Magjistraturës bazuar në rezultatet e tyre të studimeve.

Konkretisht, sipas listës së dërguar nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr.459 prot., datë 09.07.2020, renditja e të diplomuarve në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar, në vitin akademik 2019-2020, është si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...};
4. Znj. {...};
5. Znj. {...};
6. Z. {...};
7. Znj. {...};
8. Z. {...};
9. Znj. {...};
10. Znj. {...};
11. Z. {...};
12. Znj. {...};
13. Z. {...}.

Po ashtu, sipas listës së dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, po me shkresën nr.459 prot., datë 09.07.2020, renditja e të diplomuarve në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit, në vitin akademik 2019-2020, është si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Z. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...};
5. Z. {...};
6. Znj. {...}.

Të gjithë gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, për secilën nga dy kategoritë, kanë shprehur preferencat e tyre, duke renditur tre pozicione të lira për caktim në detyrë, pasqyruar në formë tabelare edhe në relacionin që ju është shpërndarë për të dy kategoritë e magjistratëve, të cilat nuk po i citoj një për një.

Ndaj sa më sipër, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 39, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përmbushje të funksionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas shkronjës “b”, të nenit 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimet për caktimin në pozicion të secilit gjyqtar të emëruar më datë 20.10.2020.

Në këto propozime Komisioni ka mbajtur në konsideratë së pari, renditjen e tyre në listat përkatëse të të diplomuarve të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe, së dyti, për aq sa ka qenë e mundur, preferencat e tyre.

Vlen të përmendet se për kategorinë e të diplomuarve në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar, për 11 të emëruar, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e parë të tyre. Për 1 të emëruar tjetër, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e dytë të tij. Vetëm për 1 të emëruar, atij të renditur në fund të listës së të diplomuarve, propozimi për caktimin në pozicion nuk konsiston në asnjë nga preferencat e tij.

E njëjta gjë vlen të përmendet edhe për kategorinë e të diplomuarve në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit, ku për 5 të emëruar, propozimi për caktimin në pozicion konsiston në preferencën e parë të tyre. Vetëm për 1 të emëruar, atij të renditur në fund të listës së të diplomuarve, propozimi për caktimin në pozicion nuk konsiston në asnjë nga preferencat e tij.

Vlen të theksohet se, sipas shkronjës “a”, pika 1, të nenit 41 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”, parashikohet se “I emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40, të këtij ligji, duke përfshirë: a) pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij; ...”.

Lidhur me caktimin në pozicion në gjykatën e vetme administrative të shkallës së parë të shpallur nga Këshilli, Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 5, të nenit 39, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në

administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës". Në fakt, të 6 gjyqtarët e emëruar, që përfshihen në kategorinë e të diplomuarve në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit, plotësojnë të dy kriteret e përcaktuara nga ligji. Ata kanë që të gjithë përvojë pune të paktën një vit e gjysmë në administratën publike, në kushtet ku më herët kanë punuar për disa vite si këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë apo si ndihmës ligjorë në gjykatat administrative. Po ashtu, ata që të gjithë janë vlerësuar me rezultatin "shumë mirë" në lëndën e të drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës.

Më konkretisht, propozimet sipas pikave 1 të projektvendimeve respektive konsistojnë në caktimin në pozicion të gjyqtarëve të emëruar si më poshtë:

Magjistratët e formimit trevjeçar:

1. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;
2. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
3. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
4. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
5. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
6. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
7. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
8. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
9. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
10. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
11. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
12. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
13. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;

Ndërsa për magjistratët e formimit dyvjeçar, propozimet konsistojnë si më poshtë:

14. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
15. Z. {...} pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë;
16. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
17. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
18. Z. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
19. Znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në pikat 2 të projektvendimeve përcaktohet se ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit, kjo në përputhje me përcaktimin e pikës 3, të nenit 37, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “3. ... Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të ushtrimit të funksionit të magjistratit.”.

Në pikat 3 të projektvendimeve përcaktohet se marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020. Në këtë rast është mbajtur parasysh se fillimi i ushtrimit të funksionit, pra bërja e betimit, është kusht pa të cilin magjistrati nuk mund të ushtrojë funksionin dhe, për pasojë, të gëzojë të drejtat e rrjedhura nga statusi i magjistratit. Nga ana tjetër, statusi i magjistratit fitohet me emërimin e tij, referuar pikës 2, të nenit 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit”.

Në pikat 4 të projektvendimeve përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit përkatës sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe gjykatës përkatës të rrethit gjyqësor ku ai caktohet.

Në pikat 5 të projektvendimeve përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo në përputhje me përcaktimet e bëra: - në pikën 2, të nenit 41, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë”; - si dhe në pikën 1, të nenit 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!
Kemi ndonjë diskutim?
Nëse jo, kalojmë në miratimin e secilit prej këtyre akteve.
Jeni dakord me të gjitha?
Fillojmë me aktin e parë, që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në caktimin në pozicion të znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, propozimi për caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin lidhur me caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës caktimi në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër, që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit në adresën postare dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me propozimin për caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Caktimi në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarës së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...}, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...}, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...}, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës. Caktimi në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jeni dakord me propozimin e Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...}, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Caktimi në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}. Jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...}, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projektvendimin e radhës. Caktimi në pozicion të gjyqtares së emëruar znj. {...}. Jemi dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë pas fillimit të ushtrimit të funksionit, nga dita e emërimit gjyqtar, datë 20.10.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...}, në adresën elektronike si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq përfunduar çështjen e parë të rendit të ditës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e Nëpunësit Përgjegjës për vlerësimin z. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 14:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e Nëpunësit Përgjegjës për vlerësimin z. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës e cila ka të bëjë me projektvendimin “Për zëvendësimin e Nëpunësit Përgjegjës për vlerësimin z. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”. Ky projekt-akt është propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Do relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të neneve 85 dhe 97 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 dhe 264 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar, për periudhën e vlerësimit viti 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kushtet e kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Posaçme, me vendimet nr. 247, nr. 314, dhe nr. 337, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këto vendime, janë caktuar nëpërmjet procedurës së shortit, relatori dhe nëpunësi përgjegjës për secilin gjyqtar. Për 11 (njëmbëdhjetë) nga 33 (tridhjetë e tre)

gjqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e vlerësimit viti 2019, është caktuar nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. {...}.

Paralelisht me këtë procedurë vlerësimi, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale po zhvillon procesin e vlerësimit për gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, konkretisht me anë të procedurës së shortit, për efekt të kësaj procedure, janë përzgjedhur relatorët dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për 8 nga 24 gjyqtarët për të cilët zhvillohet kjo procedurë, viti i vlerësimit 2013-2016, është caktuar nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. {...}.

Nga ana tjetër, Këshilli, me vendimin nr. 245, datë 12.10.2020, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë KLGJ. Në pikën 2 të vendimit se efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 30.11.2020. Ndërkohë me vendimin nr. 453, datë 19.10.2020, Këshilli ka vendosur gjithashtu komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve për një periudhë 2-vjeçare, e cila fillon në datë 20.10.2020.

Lidhur me caktimin dhe zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në nenin 12, pika 2 të Vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, parashikohet se:” Bazuar në listën e mësipërme, mbledhja plenare e Këshillit cakton me short relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës...”.

Duke iu referuar dinamikës së procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të filluar tashmë, prioritetet dhe urgjencën që dikton ky proces, fazën në të cilën ndodhen procedurat e vlerësimeve si dhe ngarkesën e dy nëpunësve të tjera të cilat janë caktuar në cilësinë e vlerësuesit në një numër të njëjtë procesesh, Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se ka vend për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin {...} në të gjitha procedurat e vlerësimit në të cilat ai është përzgjedhur, me nëpunësen e cila sapo ka marrë detyrën znj. {...}. Ky zëvendësim garanton barazinë në shpërndarjen e punës midis të tre nëpunësve aktualë të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, të cilët janë angazhuar në këtë proces.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nëpunësi përgjegjës për vlerësimin {...}, duhet të zëvendësohet në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim caktimin e nivelit të vlerësimit (gradim), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për 8 gjyqtarë dhe në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit viti 2019, për 11 gjyqtarë.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 89 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 12 të Vendimit të e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin “Për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin z. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i këtij nëpunësi me znj. {...}, në të gjitha procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të filluara në të cilat ai është përzgjedhur si vlerësues.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, çka do të sjellë më pas njoftimin e secilit nga gjyqtarët kandidatë në procedurat e ngritjes në detyrë, me zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin z. {...} me zonjën {...}, në të gjitha procedurat e vlerësimit etik dhe profesional në të cilat ai është përzgjedhur me short si vlerësues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.10.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

3.1 “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}”

3.2 “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”.

3.3 “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 14:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

3.1 “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}”

3.2 “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”.

3.3 “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës.

Siç e relatova, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur tre projekt-akte, duke pasur parasysh përfundimin e afatit të komandimit pranë Gjykatës së Lartë të magjistratit {...} dhe kërkesën e tij për të shërbyer në skemën e delegimit.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime lidhur me magjistratin {...}. 1. Lidhur me përfundimit e kohëzgjatjes së komandimit të tij si

ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë; 2. Për komandimin në skemën e delegimit; dhe 3. Caktimin e tij në Gjykatën e Apelit Durrës.

Projektvendimi i parë lidhet me deklarin e përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të zotit {...}.

Po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur faktet e paraqitura në këtë relacion.

Me vendimin nr. 104, datë 04.11.2016 ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: “Komandimin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë z. {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 3-vjeçare”.

Me vendimin nr. 227, datë 22.10.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit.”

Me shkresën nr. 1732/1 prot., datë 29.07.2020, Gjykata e Lartë i ka parashtruar Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë për përsëritjen e komandimit të z. {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 1-vjeçare. Kjo kërkesë është bazuar në kërkesën e parashtruar nga z. {...} si dhe në nevojat e gjykatës.

Me datë 24.09.2020, gjyqtari {...}, i është drejtuar sërish Këshillit të Lartë Gjyqësor duke parashtruar heqjen dorë nga kërkesa e tij për konfirmim si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 1-vjeçare.

Sa sipër, bazuar në pikën 1 të nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se Këshilli duhet të shprehet lidhur me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, me datë 04.11.2020.

Në këto kushte Komisioni, i ka paraqitur Këshillit për miratim projektvendimin përkatës me anë të të cilit i propozon Këshillit:

Deklarimi i përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, më datë 04.11.2020.

Ky është projektvendimi i parë.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektvendimit të parë, sipas propozimit...

Brunilda Kadi: Një sekondë, një pyetje të lutem.

Në lidhje me këtë komandim, nuk kapërcehet 5-vjeçari?

Ilir Toska: Është vendimi për mbarimin e komandimit në Gjykatën e Lartë.

Brunilda Kadi: I ka bërë 4 vjet tashmë.

Marçela Shehu: 4 ka tani.

Brunilda Kadi: Do të thotë që maksimumi mund të rrijë i komanduar edhe 1 vit.

Ilir Toska: Jemi tek projektvendimi që deklarojmë mbarimin e komandimit në Gjykatën e Lartë.

Marçela Shehu: Projektvendimi i parë lidhet me përfundimin e komandimit në Gjykatën e Lartë, më 04.11.

Tek projektvendimi i dytë pastaj do diskutohet përfshirja në skemën e delegimit.

Brunilda Kadi: Gjithsesi, arsytimi i përfundimit është sepse ai heqë dorë ngaqë do të kandidojë.

Marçela Shehu: Jo, ai nuk heq dorë.

Atij, më 04.11.2020 i mbaron afati i komandimit.

Fillimisht bëri një kërkesë tjetër për t'u rikonfirmuar si ndihmësmagjistrat dhe më pas hoqi dorë nga kjo kërkesë, duke paraqitur kërkesën tjetër për përfshirjen në skemë delegimi. Por që Këshilli të shprehet për përfshirjen ose jo në skemë delegimi, ne menduam që fillimisht të shprehemi për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit në Gjykatën e Lartë.

Brunilda Kadi: Kuptoj. Që do të thotë që në qoftë se s'ka kërkesë për të vijuar komandimi, qoftë në skemë delegimi, qoftë në Gjykatë të Lartë, ne nuk ka nevojë të marrim vendim sepse thjesht shkon data kur i mbaron komandimi, apo duhet të kemi një vendim deklarativ për mbarimin e komandimit në Gjykatë të Lartë?

Ilir Toska: Kemi çmuar që të bëjmë një vendim deklarativ.

Marçela Shehu: Po, kemi menduar që duhet një vendim deklarativ, për sa kohë do të shprehemi dhe për kthimin e tij në gjykatën nga ku ardhur, në rastin nëse do të shpreheshim, jo në këtë rast. Duke qenë se 57, pika 1 dhe 4 shprehen lidhur me atë çka ka ndodhur me magjistratin pas përfundimit të komandimit.

Brikena Ukperaj: Në fakt, ajo që kuptoj unë, ne jemi vënë në lëvizje jo nga kërkesa e zotit {...}, jemi vënë në lëvizje nga kërkesa e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë për zgjatje të afatit të komandimit dhe kusht për zgjatjen e afatit të komandimit duhet të jetë edhe konfirmimi i ndihmësmagjistratit që ai ka qenë dakord.

Ilir Toska: Në fakt, procedura fillon me kërkesën e ndihmësmagjistratit.

Brikena Ukperaj: Procedura, sipas nenit 56, pika 2, fillon me kërkesë të kryetarit sepse në këtë rast jemi në zgjatje të komandimit.

Ilir Toska: Në Këshill, kërkesën e paraqet Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Brikena Ukperaj: Po! –dhe duhet konfirmimi.

Ilir Toska: Kryetari, që të bëjë kërkesën, duhet konfirmimi i ndihmësmagjistratit, se s’ mund të bëjë kërkesë po s’do magjistrati.

Brikena Ukperaj: Dhe vet magjistrati nuk e bën dot që të kërkojë zgjatje në qoftë se nuk është dakord Kryetari. Kjo është logjika.

Pra ky e ka dhënë një herë pëlqimin për zgjatje dhe pastaj ka thënë që unë nuk dua. Jemi në kushtet që nuk mund të pranohet kërkesa e kryetarit për zgjatje të afatit të komandimit.

Ilir Toska: Ka rënë dhe mbaron mandati në mënyrë të natyrshme.

Thjesht duhet të deklarojmë mbarim.

Brikena Ukperaj: Mos duhet të thoshit mospranimin e kërkesës për zgjatje të komandimit apo nënkuptohet kjo gjë?

Ilir Toska: Duke e deklaruar mbarimin, çfarë nënkupton?

Brunilda Kadi: Këtu tek projektvendimi nuk thuhet që ai kthehet në Gjykatën e Vlorës. Është moment më vete ai pastaj.

Marçela Shehu: Sepse projektvendimi i dytë lidhet me propozimin për t’u përfshirë në skemë delegimi.

Brunilda Kadi: Okej! Por në kohë, në fillim merret ky vendimi, pastaj vijohet diskutimi për vendimin tjetër. A duhet ky vendimi të ketë të parashikuar këtë pjesën e kthimit të tij në gjykatën nga ka ardhur, apo jo?

Do futet apo s’do futet në skemë delegimi, ajo është çështje tjetër. Është një moment tjetër.

Marçela Shehu: Fillimisht ishte pjesë e projektvendimit, por duke qenë se Komisioni vinte edhe me një propozim tjetër, menduam që formalisht nuk kishte pse të ishte. Por gjithsesi, nëse vlerësoni që duhet të jetë pjesë për të mos paragjykuar vendimmarrjen tjetër të Këshillit, mund ta shtojmë kthimin në Gjykatën e Vlorës.

Brunilda Kadi: Se kjo është edhe arsyeja pse po i marrim vendimet veç e veç apo jo dhe logjikisht veç e veç duhen marrë, siç edhe kemi marrë tek rastet e tjera që kemi pasur.

Marçela Shehu: Doni ta shtojmë pikën e dytë kthimin në Gjykatën e Vlorës?

Brunilda Kadi: Po! Sepse në fund të fundit, shkak ligjor i këtij vendimi, pavarësisht faktit të njohur që ai ka bërë kërkesë për skemë delegimi dhe ju vini me një projektvendim, por në këtë moment tani, ne nuk e dimë se çfarë do vijë në të ardhmen mbas këtij vendimi. Në këtë moment ne duhet të shprehemi që magjistrati, për shkak se i mbaron komandimi sipas vendimit tonë të mëparshëm më datë 04.11.2020, ju vlerësuat që është mirë që të bëhet një vendim deklarativ, dhe unë ashtu mendoj, që duhet të bëhet në fakt sepse për shembull mund të ishte një situatë e ndryshme faktike që vendi i tij për shembull mund të ishte suprimuar në gjykatë dhe ne duhet të vendosim se ku do kthehet. Kështu që është e nevojshme që të deklarohet kjo gjë. Kështu që unë mendoj që duhet të shtohet tek dispozitivi kthimin e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky vendim i jep efektet menjëherë sepse deklarativ është.

Ilir Toska: I jep efektet kur mbaron.

Marçela Shehu: Me datë 4.

Brunilda Kadi: Dakord. A ka nevojë që të publikohet dhe të marrë formë të prerë? Nuk është nga ato akte që e ka të nevojshme këtë gjë.

Pyetja është më tutje, a pengohemi ne të vijojmë ne me vendimin tjetër pa marrë fuqi ky vendimi?

Marçela Shehu: Pa i sjellë efektet më datë 4?

Ne mendojmë që jo.

Brunilda Kadi: Ai mund ta ankimojë këtë vendimin, apo jo?

Ilir Toska: Teorikisht.

Marçela Shehu: Teorikisht. Se ajo është çështje fakti, kur fillon, kur mbaron.

Me datë 4 mbaron.

Brikena Ukperaj: Ne mund të vazhdojmë me vendimin tjetër por duhet t'i japim efekte vendimit tjetër pas datës 4.

Marçela Shehu: Me datë 5 është propozuar vendimi tjetër.

Brunilda Kadi: A ka të drejtë ankimi ai për këtë vendimin?

Mund ta kishit kthyer në një vend tjetër. Po flasim potencialisht, a ka të drejtë ankimi ai?

Alban Toro: Pozicioni i tij i përhershëm është në Vlorë. Ndërkohë që përfshirja në skemën e delegimit, e ka dhënë pëlqimin dhe nuk besoj se...

Brunilda Kadi: Do shkojë apo nuk do shkojë në skemën e delegimit atë nuk e dimë neve Alban, se është vendim tjetër i Këshillit.

Alban Toro: Po pra, është vendimi i dytë.

Brunilda Kadi: Nuk ka lidhje. Nuk kemi shkuar kronologjikisht tek ai vendim.

Alban Toro: Marçela po thotë që është dakord që në qoftë se mendohet e nevojshme ta çojmë në Vlorë...

Brunilda Kadi: Që ai shkon në Vlorë me këtë vendimin, kjo nuk ka diskutim.

Alban Toro: Ankim aty pastaj nuk besoj se ke sepse nuk e di për çfarë do ta ketë.

Brunilda Kadi: Nuk është çështje besimi, është çështje çfarë thotë ligji. Që të marrë formë akti, nëse ai ka të drejtë ankimi për këtë vendim, duhet të jepet, të marrë formë të prerë ky vendimi dhe pastaj vijojmë me vendimin tjetër.

Ilir Toska: Ky vendim është deklarativ. Është marrë në kushtet kur nuk ka më kërkesë për zgjatje mandati, siç e njeh ligji.

Brunilda Kadi: Ka një shkak ligjor pse u mor ky vendimi.

Atij i mbaron afati për të cilin ia dhamë. Pra për të gjitha arsyet që u dhanë. Me mbarimin e komandimit, a kthehet në gjykatën nga ka ardhur ky gjyqtari?

Ilir Toska: Po!

Brunilda Kadi: Shumë bukur!

Të thuhet kjo. T'i jepet e drejta e ankimit, se ai mund të thotë: -Jo, nuk më takon mua. Ka pretendime, -ç' rëndësi ka. A e ka potencialisht të drejtën e ankimit?

Ilir Toska: Po!

Brunilda Kadi: Po flas njëherë nga pikëpamja e fuqisë juridike.

Ilir Toska: E drejta e ankimit për të deklaruar mbarimi?

Brunilda Kadi: Edhe caktimi, në vendin ku do kthehet.

Marçela Shehu: Unë mendoj që nuk ka pse të ketë ankim një vendim deklarativ. Ajo është çështje fakti. Atij më datë 4 i mbaron afati i komandimit dhe kaq.

Brikena Ukperaj: Kur bëhet mbarimi statusit të gjyqtarit me heqje dorë, a parashikojmë të drejtë ankimi? Vendim deklarativ e kemi. Deri më 5.11 kemi kohë. E shtyjmë.

Marçela Shehu: Për sa kohë gjyqtari ka bërë edhe kërkesë për përfshirje në skemë delegimi.

Brunilda Kadi: Diskutimin unë e kam formal.

Nga pikëpamja formale, a marrim dot ne një vendim të dytë pa marrë ky vendim formë të prerë? Këtë po them unë.

Marçela Shehu: Vendimi i krijon efektet më datë 4

Brunilda Kadi: Marçela, pavarësisht se ne mund ta dimë për shkak të arsyeve të tjera që magjistrati mund ta ankimojë këtë vendim, nga ana formale duhet të marrë formë të prerë, t'i jepet e drejta e ankimit siç e ka ligji dhe të kalojnë ato afatet, pastaj marrim vendimin tjetër. Unë kështu e mendoj. Nuk është se dëmton procesin. Në fund të fundit, ai vendimi tjetër që propozohet nga Komisioni juaj mund të merret në datën ekzakt, domethënë në kohën maksimalisht të mundshme që mund ta marrim, që i bie data 5. Sa i bie që të marrë formë të prerë ky vendimi?

Alban Toro: Për të mos e zvarritur, Bruna, ne marrim këtë vendimin tjetër dhe aty fusim një paragraf që nëse do të ketë ankim, pezullojmë prezencën në skemë delegimi.

Brunilda Kadi: Unë e mendoj që nga ana procedurale formale nuk mund ta marrim vendimin tjetër. Domethënë, duhet të shtohet këtu që gjyqtari kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; e drejta e ankimit; dhe pastaj kur të vijë ai momenti tjetër, e diskutojmë. Se ndoshta ky diskutimi u bë paraprakisht për të kuptuar gjithë këtë gjë. Ndoshta më kuptim ka që të bëhet në momentin kur diskutohet projektvendimi tjetër.

Marçela Shehu: Për sa kohë gjyqtari ka bërë një kërkesë të dytë, se e ka kuptuar që i mbaron komandimi në datë 4, nuk besoj se ka sens tani të themi se ky është vendimi i Këshillit dhe mund ta ankimosh vendimin e Këshillit. Ligji është i qartë. Ai është magjistrat. Neni 57 parashikon që me përfundimin e komandimit ai kthehet në gjykatën...

Brunilda Kadi: Nga ana formale, në tekstin tek dispozitivi në vendim, nuk ka nevojë që të shtohet që ai kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë?

Marçela Shehu: Jam dakord. Kjo pikë mund të shtohet.

Brunilda Kadi: ...dhe të drejtën e ankimit. Ta votojmë kështu dhe kur të vijë momenti i projektit tjetër e votojmë, gjithsekush ka mendimin e vet. E votojmë në qoftë se ju si Komision propozoni që të shtohen këto dy disponime, pra që ai kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të drejtën e ankimit. Pastaj kur të vijë momenti i projektvendimit tjetër e diskutojmë që e marrim apo s'e marrim dot.

(Pas disa minustash shkëputjeje të linjës së internetit rifillon mbledhja.)

Naureda Llagami: Atëherë edhe një herë. Jemi në linjë për shkak të problematikës që pati interneti.

E lamë diskutimin tek zonja Kadi. Nuk e dimë çfarë është regjistruar Bruna, kështu që riformuloje të lutem edhe një herë sepse nuk e dimë sa kemi qenë "online". Na e riformulo edhe një herë propozimin që ke për projekt-aktin.

Brunilda Kadi: Atëherë, unë vlerësoj që tek dispozitivi i vendimit duhet të shtohet një pikë pas pikës 1, me përmbajtjen "Kthimin e gjyqtarit {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë"; dhe pjesa tjetër vijon, pika 2 bëhet 3 dhe pika 3 bëhet 4.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Kalojmë një herë propozimin e bërë nga zonja Kadi që aktit t'i shtohet kjo dhe më pas kalojmë në miratimin në tërësi të projekt-aktit. Kështu hedhim në votim propozimin e zonjës Kadi.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalojmë në projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord. Përderisa Këshilli e mori vendimin dhe nuk e pranoi propozimin që bëra unë, votoj pro këtij propozimi.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të deklarojë përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit {...} si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë më datë 04.11.2020. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 04.11.2020. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Prapë sërish ia jap fjalën zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Projektvendimi i dytë i propozuar ka lidhje me propozimin e Komisionit për përfshirjen dhe komandimin e zotit {...} në skemën e delegimit, marrë

shkas edhe nga kërkesa e paraqitur nga magjistrati, kërkesë e paraqitur më datë 28.09.2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në analizë të fakteve dhe të dhënave që lidhen me magjistratin, parë këto në lidhjen dhe me parashikimin e nenit 45 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në lidhje me parashikimet e vendimit nr. 22, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarit {...} në skemën e delegimit, pra komandimit të tij në këtë skemë, pasi gjyqtari ka dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e kryetarit apo të zëvendëskryetarit; është caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj, pasi aktualisht, pavarësisht se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ushtrojnë funksionin 10 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 14. Këshilli sapo ka përfunduar edhe procesin e caktimit të magjistratëve të sapo diplomuar; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet që gjyqtari {...} plotëson kriteret për t’u komanduar në skemën e delegimit. Në këto kushte Komisioni i propozon Këshillit pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 1 vit që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 05.11.2020. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky është propozimi i paraqitur nga Komisioni.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Brunilda Kadi: Po, kam unë diçka Kryetare.

Atëherë, mendoj që tek pika 2, “zgjatet në varësi të rrethanave”, unë mendoj që nuk ka mundësi në rastin e këtij gjyqtari sepse 1 vit është maksimumi që mund të rrijë në skemë delegimi si i komanduar, pasi siç del nga e gjithë ajo që u diskutua, ai tashmë i ka

bërë (në 4 nëntor) 4 vjet, dhe 1 vit (5), kështu që është në maksimumin e kohës që mund të rrijë i komanduar në mënyrë të pandërprerë. Kështu që mendoj që mund t'i ndërpritet, nuk do ketë nevojë, ose me kërkesë të tij, por zgjatjen mendoj që objektivisht është e pamundur.

Marçela Shehu: Komisioni është dakord me propozimin tuaj. Kështu që ne propozojmë që fjala “të zgjatet..” në bazë të propozimit, të hiqet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Okej! Faleminderit për pranimin dhe për dakordësinë.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga zonja Kadi, pranuar edhe nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Sërish fjalën për zonjën Shehu.

Marçela Shehu: Projektvendimi tjetër lidhet me propozimin e Komisionit për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Durrës. Pas miratimit nga ana e Këshillit të projektvendimit të mëparshëm për përfshirjen e zotit Kalaja në skemën e delegimit, Komisioni ka përgatitur projektvendimin tjetër, për caktimin e këtij gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës. Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata e e Apelit Durrës e cila aktualisht është në një numër të kufizuar gjyqtarësh, ku në detyrë janë

vetëm 5 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 13, një numër ky i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e çështjeve të regjistruara dhe në pritje për t'u gjykuar në këtë gjykatë, ndërkohë që ajo në vijimësi ka paraqitur nevojë, për një numër të lartë çështjesh, për caktim gjyqtarësh nga gjykatat e tjera të apelit.

Në një situatë të tillë, Gjykata e Apelit Durrës është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë të një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, por në veçanti, të çështjeve tepër urgjente dhe urgjente.

Meqenëse gjyqtari {...}, tashmë u përfshi në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nisur nga nevojat e Gjykatës së Apelit Durrës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e tij në këtë gjykatë, për periudhën njëvjeçare të komandimit në këtë skemë.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se gjyqtari {...} ka përvojë profesionale mbi 8 vjet, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të këtij ligji, sipas të cilës: “4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie: a) në çdo pozicion të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; ...”.

Bazuar në sa më sipër është paraqitur dhe propozuar projektvendimi përkatës për caktimin e këtij gjyqtari pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 05.11.2021.

Naureda Llagami: Keni ndonjë diskutim?

Kalojmë në votim të projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.10.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

- 4.1 “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”;
- 4.2 “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”;
- 4.3 “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 14:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

- 4.1 “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”;
- 4.2 “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”;
- 4.3 “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin e radhës, janë tre projekt-akte të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Konkretisht po ia jap fjalën zotit Ilir Toska për propozimin e këtyre tre akteve.

Ilir Toska: Faleminderit!

Projektvendimi i parë i propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë”. Përmes këtij projektvendimi i propozohet Këshillit që të deklarojë përfundimin para kohe të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. Engert Pëllumb si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë dhe efektet juridike të vendimit të fillojnë nga data 4 nëntor 2020.

Sa i përket komandimit të zotit {...} pranë Gjykatës së Lartë, është bërë me vendimin nr. 14, datë 10.02.2017 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për një afat 3-vjeçar, ndërkohë që me vendimin nr. 33, datë 23.01.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur zgjatjen e këtij komandimi edhe për 1 vit. Ndërkohë rezulton se afati i komandimit pas zgjatjes së tij për gjyqtarin zotin {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, përfundon më datë 10 shkurt 2022.

Nga ana tjetër, marrë shkas nga thirrja publike e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari {...}, më datë 23 tetor ka depozituar pranë Këshillit një kërkesë përmes së cilës ka shprehur interesin për t'u komanduar në vijim në skemë delegimi. Aktualisht, në Gjykatën e Lartë ushtrojnë detyrën 3 gjyqtarë, ndërsa Këshilli është në proces për plotësimin e kësaj gjykate edhe me 12 gjyqtarë. Ndërkohë, në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë aktualisht ushtrojnë detyrën 8 ndihmësmagjistratë dhe 6 këshilltarë ligjorë. Në ditët në vijim, pritet që Këshilli të emërojë përkohësisht edhe 4 këshilltarë ligjorë të cilët kanë përfunduar dhe janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.

Nga ana tjetër, në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, sa i përket juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, numri i gjyqtarëve në detyrë ka rënë ndjeshëm si rezultat i zbatimit të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të dorëheqjeve të gjyqtarëve apo dhe komandimit të tyre. Aktualisht, në këto gjykata ushtrojnë detyrën 261 gjyqtarë, pa përfshirë 19 gjyqtarët e emëruar rishtazi që do të caktohen në pozicion (që i caktuam pak më herët), ndërkohë që sipas organikave të këtyre gjykatave ky numër është 368, pra me një diferencë prej 107 gjyqtarësh më pak apo, duke përfshirë edhe gjyqtarët e emëruar dhe caktuar ditën e sotme, kjo diferencë është 88 gjyqtarë më pak.

Ndodhur në një situatë të tillë, kur numri i gjyqtarëve në detyrë është ulur ndjeshëm në raport me atë çka, sipas organikave, duhet të jetë, si dhe kur aktualisht Gjykata e Lartë ka një numër të mjaftueshëm ndihmësmagjistratësh dhe këshilltarësh ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar se është në dobi të mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor përfundimi para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z {...}, si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë. Për këtë, Komisioni ka përgatitur edhe projektvendimin që ju është propozuar dhe

që e përmenda fillimisht. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë propozim për projekt-aktin?

Po zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Atëherë, ne, nuk ka shumë kohë, kur me kërkesë të Gjykatës së Lartë na është kërkuar që të komandonim 5 gjyqtarë si ndihmës dhe Këshilli arriti të miratojë vetëm 4, për arsyet që dihen, dhe në këto kushte, mendoj që ndërprerja e mandatit të zotit {...} pranë Gjykatës së Lartë, për të shkuar në skemën e delegimit më duket pa kuptim sepse ne sapo miratuam dhe hoqëm nga sistemi nga gjykimi në shkallë të parë 4 magjistratë, nga 5 që kërkonte Gjykata e Lartë. Kështu që, mua më duket si pa vend. Mendoj që Gjykata e Lartë ka shumë nevoja dhe i duhet Gjykatës së Lartë zoti {...} dhe nuk bën sens pastaj ajo që sapo bëmë para një javësh, dy javësh që 5 që kërkonte, 4 mundëm t'i çonim Gjykatës së Lartë. Kështu që nuk mendoj se ka kuptim që t'i ndërpritet komandimi në Gjykatën e Lartë. Ai duhet të rrijë aty sepse është i nevojshëm, i domosdoshëm dhe ne e kemi certifikuar këtë gjë me vendimmarrje kur çuam 4 magjistratët. Kështu që për këtë arsye jam kundër ndërprerjes përpara afatit të këtij komandimi.

Ilir Toska: Në fakt shpjegova situatën e Gjykatës së Lartë. Ajo çka zonja Kadi tha që ne pak më herët çuam 4 ndihmësmagjistratë është një nga arsyet sepse ne propozojmë që të mbarojë përpara afatit, janë vetëm disa muaj përpara. Nga ana tjetër, ndihmësmagjistratët që ne përfundimisht, pas kërkesës së Gjykatës së Lartë, i komandua si ndihmësmagjistrat, nuk kanë të njëjtën përvojë me zotin {...}, ndërkohë që ne sot jemi në nevojë në gjykatat e apelit ku numri i gjyqtarëve ka rënë dhe është në masën 40%. Kjo është edhe arsyeja që ne vlerësuam që duhet të ndërpritet përpara afatit komandimi në Gjykatën e Lartë të zotit {...}. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Mundem Kryetare?

Nisur nga arsyetimi që bëri zoti Toska, unë mendoj që kjo është një arsye më shumë që zoti {...} duhet të rrijë aty si nga të paktët magjistratë me përvojë për të qenë këshilltar në Gjykatën e Lartë sepse faktikisht ne çuam aty 4 gjyqtarë, ku disa prej tyre nuk kishin gjykuar fare në shkallë të parë, kështu që unë mendoj që ai i duket Gjykatës së Lartë, pikërisht për përvojën e tij.

Marçela Shehu: Po ndërkohë i duhet edhe gjykatave të apelit, i duhen magjistratë dhe i duhen magjistratë me përvojë.

Naureda Llagami: Po, zoti Qoku!

Maksim Qoku: Ne i kemi dhënë prevalencë skemës së delegimit dhe kemi thënë që në çdo rast duhet t'i japim prioritet skemës së delegimit dhe në situatën konkrete ne jemi në atë gjendjen që po jetësojmë skemën e delegimit e cila për mua është prioritare dhe ne e kemi pranuar të gjithë. Për këtë arsye, fakti që skema e delegimit pastaj na zgjidh edhe atë problemin e funksionalitetit të disa gjykatave nisur nga kriteret e veçanta që plotësojnë këto elementë/këto magjistratë, duket që është e drejtë kjo vendimmarrje që po bëjmë sot. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër, për arsyetimin që dhashë.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të deklarojë përfundimin përpara kohe të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...}, si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë me datë 04.11.2020.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i dytë. Prapë fjalën ia jap për relatin zotit Toska.

Ilir Toska: Projektvendimi i dytë i propozuar nga Komisioni është për përfshirjen në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} për një afat 1 vit që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Edhe në këtë rast zoti {...} ka shprehur, siç parashtrova pak më herët, ka dhënë pëlqimin dhe ka shprehur interes për t’u përfshirë në skemën e delegimit. Zoti {...} ka mbi 8 vjet përvojë profesionale si gjyqtar. Në këto kushte, referuar kriterëve të nenit 45 të ligjit por edhe kriteret e përcaktuara në mënyrë të hollësishme në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit, zoti {...} plotëson të gjitha këto kritere, prandaj Komisioni ka propozuar që kërkesa e tij për t’u përfshirë në skemën e delegimit, të pranohet dhe ai të komandohet në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me afat deri në 1-vit që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave, ndërsa efektet juridike të fillojnë nga data 5 nëntor 2020, pra nga dita e nesërme pasi të përfundojë përpara kohe mandati i ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë diskutim?

Brunilda Kadi: Po! –kam unë Kryetare.

Tek pika 2 e dispozitivit, përsëri do sugjeroja të shtoheshe në fund të fjalisë “por jo më vonë se data 10.02.2022”, që është në fakt afati maksimal që gjyqtari mund të rrijë i komanduar. Edhe mund të mos e themi.

Ilir Toska: Kur të shkojë viti ne do duhet të shprehemi përsëri. Është e tepërt të shkruajmë edhe një datë nëse ne e përsërisim komandimin.

Brunilda Kadi: Okej! E diskutueshme është, me afat deri në 1 vit.

Ilir Toska: Një vit është ajo.

Marçela Shehu: Mbase kur t’i mbarojë 1-vjeçari dhe mund të rikonsiderohet...

Brunilda Kadi: Pra ndërprerja ose zgjatja do jetë me vendim.

Ilir Toska: Patjetër!

Brunilda Kadi: Mirë, atëherë e tërheq propozimin.

Naureda Llagami: Dakord.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord. Por, pavarësisht se unë isha kundër ndërprerjes, në kushtet kur Këshilli vendosi me shumicë që u ndërpre mandati, atëherë për pjesën tjetër jam dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit që ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës. Sërish fjalën zoti Toska.

Ilir Toska: Projektvendimi i fundit i propozuar nga Komisioni është caktimi i gjyqtarit tashmë të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë, për periudhën deri në datën 5 nëntor 2021, që është periudha 1-vjeçare e përfshirjes së tij në skemë delegimi, me vendimin që miratuam më herët.

Edhe në këtë rast është mbajtur në konsideratë situatat që janë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në rastin konkret, Gjykata e Apelit Vlorë, e cila aktualisht funksionon me numër të përgjysmuar gjyqtarësh, ndërkohë që 5 prej tyre janë ende në proces rivlerësimi kalimtar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.10.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë (shtyrë nga mbledhja e datës 20.10.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 14:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë (në sallë).*
- 8. Periand Teta, Këshilltar i Kabinetit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).*
- 9. Sokol Gjini, Avokat me prokurë i z. {...} (në sallë).*

RENDI I DITËS:

5. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë (shtyrë nga mbledhja e datës 20.10.2020).

Naureda Llagami: Atëherë, siç jeni në dijeni, në rendin e ditës është zhvillimi i seancës dëgjimore ndërmjet ILD-së dhe magjistratit {...}.

Ne e kemi shtyrë nga seanca tjetër dhe kemi përcaktuar orën 12:00. Unë do doja tani që të ftonim të dy palët.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, si dhe z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po hapim seancën dëgjimore.

Siç jeni në dijeni, kjo seancë dëgjimore vijon nga mbledhja plenare e datës 20 tetor 2020. Pas shqyrtimit të procedimit dhe parashtrimit të palëve në atë seancë, Këshilli vendosi që t'i japë kohë gjyqtarit nën procedim për njohjen me dokumentacionin e procedimit disiplinor në funksion të ushtrimit të së drejtës efektive të mbrojtjes si dhe në garantimin e parimeve themelore të ligjshmërisë dhe të një procesi të rregullt ligjor. Kështu, një kopje e dokumentacionit lidhur me procedimin, i janë vënë në dispozicion përfaqësuesit të magjistratit përmes shërbimit postar magjistratit, ku është konfirmuar edhe marrja nëpërmjet nënshkrimit nga magjistrati, më datë 24.10.2020.

Atëherë, le të fillojmë çeljen e vazhdimit të seancës dëgjimore.

Verifikojmë prezencën e palëve.

Nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është prezent vet Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani.

Artur Metani: Dhe këshilltari Periand Teta.

Naureda Llagami: Dhe nga ana e magjistratit, z.Sokol Gjini, përfaqësuar me prokurë të posaçme që e keni administruar në dosje që seancën e kaluar.

Atëherë, pa humbur kohë, po japim fjalën fillimisht magjistratit, lidhur me nëse keni ndonjë parashtrim apo objeksione pas njohjes me dokumentacionin e plotë të procedimit disiplinor.

(Avokati z. Sokol Gjini nuk dëgjohet gjatë fjalimit të tij.)

Naureda Llagami: Ndjesë, për ndërprerjen. Ndjesë!

Ju lutem, maskën mund ta largoni sepse e kemi të pamundur t'ju kuptojmë çfarë po lexoni.

Sokol Gjini (Avokati): Nga vetë aktet shkresore rezulton se nuk ka asnjë përgjigje apo shpjegim në lidhje me kërkesën për dorëheqje të shtetasit {...}.

E nderuar zonja Kryetare!

Duke i qëndruar parashtrimeve të bëra në seancën e kaluar të datës 20.10.2020, kemi për të sqaruar e për të shtuar se: Në nenet 127/1/c, 139 paragrafi 1/c, 147 paragrafi 1/c, 147/dh, 1/c dhe 148/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionojnë të drejtën e individit për mbarimin e mandatit me dorëheqje. Interpretimi i këtyre neneve sanksionojnë vullnetin e individit dhe detyrimin e institucioneve përkatëse shtetërore të respektojnë këtë shprehje të vullnetit të tij. Në këtë frymë të dispozitave të sipërcituara më lart të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është edhe opinioni i dhënë nga Misioni EURALIUS në Shqipëri. Në përmbajtje të këtij opinioni rezulton se në rastet kur ndaj një magjistrati caktohet masë sigurimi personal, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor ndaj magjistratit dhe ky procedim disiplinor pezullohet deri në përfundim të procedimit penal të filluar ndaj magjistratit.

Siç pranohet edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, masa e sigurimit personal ndaj shtetasit {...} është caktuar me datën 09.11.2017. Fillimi i procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është me datën 07.07.2020. Rreth 1 vit e ca pas paraqitjes së dorëheqjes nga shtetasi {...}.

Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 160 “Dispozitat kalimtare”, përcakton: “1. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët ekzistues të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj: a) ... c) vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji; ç) pezullon gjyqtarët, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj;... .”

Nga përmbajtja e opinionit dhënë nga Misioni EURALIUS rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka filluar ndonjë procedim disiplinor ndaj shtetasit {...} deri më datën 08.04.2019, datë kur ky shtetas ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Referuar sa më sipër, në bazë të neneve 64/1/a dhe 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shtetasi {...} ka shprehur vullnetin e tij për mbarimin e mandatit të gjyqtarit, me aktin e dorëheqjes. Vet dispozitat e sipërcituara kanë përcaktuar një afat prekluziv për shqyrtimin e kërkesës nga

organi i emërtesës. Vet ligjvënësi ka parashkruar si formë të shprehjes së organit administrativ miratimin në heshtje referuar nenit 97 të Kodit të Procedurës Administrative. Për miratimin në heshtje sanksionohet, neni 97: “1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda... (fjala e avokatit shkëputet për disa minuta dhe nuk ka regjistrim audio)

Naureda Llagami: Atëherë, për shkak të problemeve që patëm me linjën, do ju ftoja edhe një herë që shkurtimisht, sidomos paragrafët e fundit, të na i përmendni, për efekt regjistrimi. Por ju lutem edhe një herë, shkurtimisht.

Sokol Gjini (Avokati): E nderuar Kryetare!

Procedimi disiplinor i paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj shtetasit {...}, duke konsideruar këtë shtetas me status të gjyqtarit, bie në kundërshtim me nenin 26 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili ka përcaktuar se: “Askujt nuk mund t’i kërkohej të kryejë një punë të detyruar... .”

Në nenin 49 të Kushtetutës: “1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.”

Shtetasi {...} ka ushtruar detyrën e magjistratit në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe prej momentit të paraqitjes së dorëheqjes nuk konsiderohet më gjykatës i kësaj gjykate, pasi gjykoi se nuk mund të qëndronte në detyrë jashtë vullnetit të tij.

E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë dhe anëtarë të Kolegjit!

Në bazë të nenit 64/1/a dhe nenit 65/1/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” shtetasi {...} nuk gëzon statusin e gjyqtarit e për rrjedhojë nuk i përket këtij hetimi disiplinor.

Ndodhur në këto rrethana të sipërcituara, kërkoj pushimin e procedimit disiplinor paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me shprehje e konsideratë të lartë, shtetasi {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Në respektim të procedurës, do doja t'ia jepja fjalën nëse zoti Inspektor i Lartë i Drejtësisë ka ndonjë objeksion lidhur me sa parashtroi avokati.

Artur Metani: Në fakt ne kemi paraqitur edhe në parashtrësia, por meqenëse parashtrësia e avokatit u mbyll me pretendimin se magjistrati nuk gëzon statusin e magjistratit, dëshiroj të replikoj për këtë.

Pretendimet e magjistratit për mungesën e statusit dhe për rrjedhojë mospasjen e cilësisë së subjektit disiplinor vlerësohet se është e pabazuar. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përgjigje të informacioneve të kërkuara nga ILD me shkresën nr. 3059 prot., datë 01.07.2020, ka vënë në dijeni Inspektorin e Lartë të Drejtësisë se nga ana e Këshillit nuk është marrë ndonjë vendim në lidhje me aktin e dorëheqjes së gjyqtarit {...} paraqitur në datë 8 prill 2019. Në zbatim të nenit 64 dhe 134 (ka shkëputje linja) Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur qëndrimin se do rivlerësojë rrethanat në lidhje me aktin e dorëheqjes së gjyqtarit {...} pas përfundimit të procedurës disiplinore që do zhvillohet nga ana e ILD-së në zbatim të ligjit për Statusin.

Neni 65 i ligjit 96/2016 parashikon se parimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

Referuar këtij përcaktimi si dhe përgjigjes së KLGJ-së, vlerësohet se statusi i magjistratit nuk mbaron automatikisht me paraqitjen e kërkesës për dorëheqje. Përfundimi i statusit të magjistratit kërkon domosdoshmërisht një vendimmarrje nga Këshilli përkatës se si i vlerëson arsyet e paraqitura në kërkesë dhe merr një vendim në formën e një akti administrativ individual, nëpërmjet të cilit deklaron mbarimin e statusit të magjistratit. Ky qëndrim vjen edhe në harmoni me kompetencat e parashikuara përkatësisht në nenin 61 dhe 159 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes”, i ndryshuar, për Këshillin përkatës, i cili merr vendim për çdo aspekt të lidhur me karrierën e magjistratit nga momenti i emërimit të tij dhe deri në mbarimin e statusit dhe daljen e tij nga sistemi gjyqësor apo i prokurorisë.

Për sa më sipër, vlerësohet se pavarësisht aktit të dorëheqjes së gjyqtarit {...} nga statusi i magjistratit, nuk ka një vendimmarrje të organit kompetent (KLGJ) ndaj kërkesës së magjistratit sipas përcaktimeve të nenit 65 të ligjit 96/2016 dhe për rrjedhojë gjyqtari

{...} është subjekt i hetimit disiplinor dhe nuk ekziston asnjë shkak për mbyllje të hetimit disiplinor referuar nenit 134, paragrafi 1, shkronja /ç/ të ligjit 96/2016.

Gjyqtari ka njohur të drejtën e organit kompetent të shprehet me vendim ndaj kërkesës së tij, me anë të kërkesë së dytë paraqitur më datë 15 korrik 2019 në të cilën ka kërkuar konfirmimin me shkrim për sa do të vendosë Këshilli ndaj dorëheqjes së paraqitur prej tij.

Ky është qëndrimi i ILD-së në lidhje me pretendimin e paraqitur nga avokati.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nga kolegët ndonjë pyetje?

Erjon Muharremaj: Zoti avokat, në parashtresën tuaj përmendët të drejtën kushtetuese të subjektit të procedimit disiplinor për të siguruar mjetet e jetesës në mënyra të ligjshme.

Në ç'mënyrë mendoni që ky procedim disiplinor mund të cenojë të drejtat e zotit {...}? Faleminderit!

Sokol Gjini (Avokati): Që në momentin e paraqitjes së kërkesës më datën 08.04.2019, shtetasi {...} ka një familje, ka tre fëmijë për të mbajtur dhe ai nuk mund të rrijë peng i një kërkesë që ka paraqitur, dhe ai ka filluar punë private. Në momentin e paraqitjes së kërkesës ai nuk është më magjistrat. Ai punon në sektorin privat. Ai duhet të krijojë të mirat materiale me punë të ndershme për të mbajtur familjen.

Erjon Muharremaj: Më falni, nëse ju dëgjova korrekt, thatë që ka filluar punë në një sipërmarrje private?

Sokol Gjini (Avokati): Jo sektor privat. Pranë familjes së tij.

Erjon Muharremaj: Po! Nuk është kjo një mënyrë e ligjshme për të fituar jetesën? –në vlerësimin tuaj.

Sokol Gjini (Avokati): Në bazë të ligjit (*nuk dëgjohet fjala e avokatit për shkak ndërhyrjesh në audio*), si familje bujqësore, ka gëzuar të drejtën, ka qenë subjekt i ligjit, është një fermer i devotshëm, po punon me prindërit e tij.

Erjon Muharremaj: Pra është duke fituar jetesën me mjete të ligjshme, aktualisht?

Sokol Gjini (Avokati): Po!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Sokol Gjini (Avokati): Pasi me kërkesën e paraqitur nuk është më pjesë e gjyqësorit.

Ky i nderuar Kolegj, nga praktika vet ka pranuar kërkesa në mënyra të ndryshme, me vullnet të mirë, si për gjyqtarë të larguar nga vettingu në shkallë të parë, pa vajtur në KPA, gjyqtarë në procedim penal. Është rasti i vetëm që s'i pranohet dorëheqja një... Nuk mund të mbahet jashtë vullnetit të tij.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Pyetje tjetër nga kolegët?

Ndonjë provë për të administruar nga pala?

Sokol Gjini (Avokati): Parashtrimet.

Naureda Llagami: Parashtrimet!

Atëherë, unë i kërkoj palëve që të largohen, për të vendosur Këshilli lidhur me vijimin apo jo të shqyrtimit të çështjes.

(Dalin nga salla e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, si dhe z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

(Rihyjnë në sallën e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, si dhe z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

Naureda Llagami: Atëherë, jeni gati që të jepni pretendimet përfundimtare?

Atëherë, fjalën e ka inspektori.

Artur Metani: Unë i kam paraqitur edhe me shkrim në fakt, kështu që edhe për të mos e bërë seancën të... po them vetëm përfundimin.

I kërkoj Këshillit pranimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika d, shkronja /b/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3 e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Sokol Gjini (Avokati): E nderuar zonja Kryetare, përfundimisht kërkojmë pushimin e këtij procedimi disiplinor, të paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që bie ndesh me nenin 64/1/a dhe nenit 65/1/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Këshilli do tërhiqet për vendim.

Kështu që ju lutem, prisni përjashta.

(Dalin përsëri nga salla e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, si dhe z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

(Ftohen të rihyjnë në sallën e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, si dhe z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

Naureda Llagami: Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Shkarkimin nga detyra” të magjistratit {...}, me detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, sipas ligjit, në Gjykatën Kushtetuese.

Me kaq mbyllet seanca për sot.

Me kaq po mbyllim mbledhjen për ditën e sotshme.

Mirë u takofshim nesër!

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor